



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-0/DPK	Nr Prot	01-2683/13
Dep.		B: Prot	
Nr. I fau		Prot No	
Broj stranica	02	Data	04-09-2013
Nr. pages		Datum	
		Date	
PRISHTINE			



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.09.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr.AKK- 03-462/13,për Zyrtarin e Lartë, z.Xhelal Shabani, Zyrtar Kryesor Financiar në Kompaninë regjionale të Ujësjellësit Hidromorava në Gjilan, për shkak se Zyrtari i Lartë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.2 te ligjit Nr.04/L-051,Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksonit Publik.

Pas informatës se marrë ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-462/13, që për trajtim ka pasur Zyrtarin i Lartë, z.Xhelal Shabani, Zyrtar Kryesor Financiar në Kompaninë regjionale të Ujësjellësit Hidromorava në Gjilan .

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si Zyrtar Kryesor Financiar në Kompaninë regjionale të Ujësjellësit Hidromorava në Gjilan, është duke ushtruar edhe aktivitet tjetër në bizneset e tij private “Dudi sh.p.k dhe d.sh.p. Koneks”, ku ka qenë pronar dhe person i autorizuar e që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksonit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 27.04.2013, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme

të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z. Xhelal Shabani, Zyrtar Kryesor Financiar në Kompaninë regjionale të Ujësjetllësit Hidromorava në Gjilan, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar që ti behet një sqarim lidhur me situatën e dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit.

Zyrtarët e agjencisë e kanë njoftuar me faktet që posedon Agjencia, lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit, zyrtari i lartë z. Shabani është pajtuar për situatën në të cilën ndodhet, mirë po është arsyetuar se nuk ka qenë informuar për këtë, pasi që nuk e ka informuar askush që nga momenti i zgjedhjes si Zyrtar Kryesor Financiar në Kompaninë regjionale të Ujësjetllësit Hidromorava në Gjilan, dhe nuk ka pas njohuri për këtë situatë që mund të shkaktoj konflikt të mundshëm të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i Lartë, z. Xhelal Shabani, Zyrtar Kryesor Financiar në Kompaninë regjionale të Ujësjetllësit Hidromorava në Gjilan, gjatë këtij komunikimi është zotuar se do të veproj sipas ligjeve në fuqi dhe në afatin ligjor do të do ta marr hapa konkret për të shmang situatën e mundshme të Konfliktit të Interesit.

Me datën 31.05.2013, Zyrtari i Lartë, z. Xhelal Shabani, Zyrtar Kryesor Financiar në Kompaninë regjionale të Ujësjetllësit Hidromorava në Gjilan, ka sjellë dëshminë se i ka bërë ndryshimet e kërkuara nga AKK-ja, dhe na ka njoftuar se ka vendosur të tërhiqet nga pozita e personit të autorizuar në biznesin e tij privat "DUDI sh.p.k", dhe ka filluar procedurat për shuarjen e biznesit tjetër "d.sh.p KonEks" pasi që bie ndesh me ligjin Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit ka përcjellë ecurinë deri sa është njoftuar për vendimin final tek biznesi privat "DUDI sh.p.k". ku ka qenë në procesin e shuarjes së biznesit, mirëpo zyrtari i lartë, z. Xhelal Shabani, na ka njoftuar se është tërhequr nga pozita e personit të autorizuar dhe është në proces të mbylljes së këtij biznesi.

Andaj bazuar në dëshmitë e sjella konsiderojmë se zyrtari i lartë, z. Xhelal Shabani, Zyrtar Kryesor Financiar në Kompaninë regjionale të Ujësjetllësit Hidromorava në Gjilan, pasi ka dhënë dorëheqje nga pozitat e personit të autorizuar në bizneset e tij private ka shmangur gjendjen e mundshme të Konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

